

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË

“DN PROJECTS” SH.P.K

Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, me Ortak të Vetëm

Sot, me datë 24.05.2021 (dymijë e njëzet e një), në Tiranë, pranë selisë së shoqërisë “DN Projects” sh.p.k, me pjesëmarrjen e ortakut të vetëm z.Dritan NDOJ, (më poshtë njohur si “Ortaku”) nënshkruhet ky Akt Themelimi, si vijon:

- **z.Dritan NDOJ**, shtetas shqiptar, lindur në Pukë, me datë 22-04-1980 (njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë), mbajtës i letërnjoftimit (ID) me Nr.032754871 dhe Nr.Personal I00422060L dhe banues Tiranë në Rr.Siri Kodra, njohur këtu e mëposhtë si ortaku i vetëm i shoqërisë me pjesëmarrje në përqindje 100% (njëqind përqind), të kapitalit të shoqërisë “DN Projects” sh.p.k.

I. Themelimi

Ortaku i vetëm deklaron në unanimitet të plotë, themelimin e shoqërisë “DN Projects” sh.p.k, si një shoqëri tregtare shqiptare me përgjegjësi të kufizuar (“**Shoqëria**”).

1. Selia administrative e Shoqërisë është në adresën: **Rr.Ibrahim Rugova, Godina “Sky Tower”, Kt.3, Zyra Nr.6 Tiranë, Shqipëri.**

Shoqëria është themeluar për afat 20 (njëzet) vjeçar, i cili mund të përterihet me Vendim të Ortakut/Ortakëve.

II. Objekti

Në përputhje me statutin dhe liçensat e përfituara nga institucionet përgjegjëse, shoqëria do të kryej veprimtarite, si me poshtë:

Rikonstruksion dhe ndërtim i veprave civile si: ambjente tregtare dhe magazinimi, hotele, bar-restorante, ambjente të jashtme dhe të brëndshme banimi dhe zyrash dhe industriale si: stacione treni, nënstacione elektrike/hidraulike, shtëpi sociale etj. Konsulencë dhe përgatitje të projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri, përmbytjet dhe fatkeqësive natyrore të ndërtesave të çdo lloji, asistencë ekonomike dhe teknike të projekteve, në fushën e ndërtimit publik dhe privat. Shitje dhe Blerje materiale elektrike, hidraulike, ndërtimi, kondicionimi, bujqësore etj. Shitje dhe Blerje të pasuri të paluajtshme, dhënie, marrje me qira dhe shitje pronash, menaxhim dhe administrim pronash etj. Kryerjen e çdo lloj aktiviteti që bën pjesë në objektin e saj, që lidhet me të dhe që e mbështet atë.

III. Statuti

Ortaku i Vetëm z.Dritan NDOJ, deklaron pajisjen e Shoqërisë me Statutin e Shoqërisë.



IV. Kapitali

Kapitali themeltar i shoqërisë është 1,000 (njëmijë) lekë, i përbërë nga 1 Kuotë e Përgjithëshme. Kuota e shoqërisë zotërohet nga ortaku i vetëm i shoqërisë me numër të pjesëve 1,00 dhe pjesëmarrje në përqindje 100 % (njëqind përqind).

I gjithë kapitali i shoqërisë zotërohet nga Ortaku i Vetëm z.Dritan NDOJ, me vlerë kapitali në para 1,000 (njëmijë) lekë, me numër të pjesëve 1,00 dhe pjesëmarrje në përqindje 100 % (njëqind përqind).

Çdo kuotë i jep të drejten e një votë zoteruesit të tij.

Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga Ortaku.

V. Administratori

Shoqëria do të drejtohet nga 1 (një) Administrator. Administratori do të jetë përgjegjës për administrimin e përditshëm të Shoqërisë "DN Projects" sh.p.k, sipas kufizimeve të vendosura nga Statuti dhe legjislacionet e Republikës së Shqipërisë.

Administrator i Shoqërisë "DN Projects" sh.p.k, emërohet:

- **z.Dritan NDOJ**, shtetas shqiptar, lindur në Pukë , me datë 22-04-1980 (njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë), mbajtës i letërnjoftimit (ID) me Nr.032754871 dhe Nr.Personal I00422060L dhe banues Tiranë në Rr.Siri Kodra;
 - Administratori emërohet nga Ortaku në cilësinë e anëtarit të vetëm të Asamblesë se Përgjithshme të Shoqërisë, i cilët ka të drejtë dhe kompetencë të plotë ta shkarkojë me vendim të zakonshëm Administratorin, për çdo arsye.
 - Administratori emërohet për një afat 5 (pesë) vjeçar dhe mund të ri-emërohet me vendim asambleje të përgjithshme të ortaku/ ortakeve të shoqërisë.
 - Kompetencat dhe detyrat e Administratorit, mund të ndryshohen me vendim asambleje të përgjithshëm të ortaku/ëve të shoqërisë.

Shoqëria "DN Projects" sh.p.k, do të përfaqësohet ndaj të tretëve nëpërmjet nënshkrimit të vetëm të Administratorit të tij, të vendosur nën vulën e Shoqërisë, nëse nuk parashikohet ndryshe në Statutin e Shoqërisë dhe/ose në një vendim të ardhshëm të ortaku/ëve të shoqërisë.

ORTAKU I VETËM

z.Dritan NDOJ

